



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim për shtyp
(5 Mars 2015)

Mbi takimin e 6 të Nënkomitetit BE-Shqipëri për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën

Në ditën e sotme që përkon me ditën kombëtare të konkurrencës dhe 11 vjetorin e krijimit të Autoritetit të Konkurrencës, Autoriteti merr vlerësimet maksimale nga mbikqyrësit europianë të konkurrencës, lidhur me aktivitetin e institucionit dhe veprimtarinë e tij në drejtim të përafrimit të legjislacionit, rastet hetimore dhe vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës.

Vlerësimet u bënë sot datë 05.03.2015 në Bruksel, ku po zhvillohet takimi i gjashtë i Nënkomitetit BE-Shqipëri për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën.

Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj.Lindita Milo (Lati) informoi Komitetin mbi përafrimin e legjislacionit, zbatimin e Ligjit dhe vendimmarrjen në fushën e konkurrencës, si dhe rritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Autoritetit të Konkurrencës.